



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 44 regjistër (JR)
Datë 02.10.2020

Nr. 10 i vendimit
Datë 27.03.2023

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 27.03.2023, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në Tiranë, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 44/2020 (JR), datë 02.10.2020, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Blerim Tominaj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 261, datë 16.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Blerim Tominaj.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës; nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 47 dhe neni 51, pika 1, germat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi

pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të ngritura në ankim dhe në parashtrimet me shkrim të dorëzuara në Kolegjin e Posaçëm të Apëlimit (në vijim “Kolegji”) para seancës gjyqësore, i cili kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 261, datë 16.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe, bazuar në nenin 179/b, pika 3 e Kushtetutës, ai i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”).
2. Bazuar në nenet 33, 39 e 43 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).
3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe KLP-ja, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit dhe, duke u bazuar vetëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, në përputhje me pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, mori vendimin objekt shqyrtimi.

II. Në lidhje me vendimin e Komisionit

4. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar, duke konstatuar se:
 - a) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin;*
 - b) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për pasuritë e trashëguara nga babai;*
 - c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
 - ç) *nuk ka kryer deklarim të rremë; dhe*
 - d) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
5. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ, e njohu subjektin e rivlerësimit Blerim Tominaj me rezultatet e këtij hetimi duke i dhënë mundësinë të paraqiste shpjegimet dhe provat e tij, si dhe pasi e dëgjoi atë në seancë dëgjimore publike, nëpërmjet përfaqësuesit Adriatik Cama, në përfundim të procesit të rivlerësimit, vendosi shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, bazuar në konkluzionet e mëposhtme.
 - 5.1. Lidhur me apartamentin me sip. 164 m², në rr. “{***}”, Tiranë, të përfutuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2007, me vlerë 2.000.000 lekë, Komisionit i rezultuan:

- a) mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, në shumën (-) 2.146.577 lekë;
- b) mospërputhje deklarimesh të subjektit për burimin e krijimit të kësaj pasurie;
- c) çmimi i blerjes së pasurisë është joreal dhe shumë i ulët krahasuar me çmimet e referencës sipas EKB-së;
- ç) çmimi i blerjes së pasurisë nga subjekti është më i ulët nga sa e ka blerë shitësi (motra).

Për sa më sipër, për Komisionin, nuk u provuan bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e kësaj pasurie.

5.2. Lidhur me lokalin me sip. 75 m², në rr. “{***}”, Tiranë, të përfituar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2011, me vlerë 140.000 euro, Komisionit i rezultuan:

- a) mungesë burimesh të ligjshme në shumën totale prej (-) 10.293.148 lekësh, duke marrë parasysh huan, edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk e ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të huas, pasi mbeti e paprovuar kryerja e transaksionit ndërmjet tij dhe huadhënësit;
- b) mospërputhje deklarimesh në lidhje me burimin e krijimit;
- c) nuk u provuan me dokumentacion ligjor pagesat e kryera për blerjen e kësaj pasurie;
- ç) në DPV-në e vitit 2010 nuk ka deklaruar pagesën e dy kësteve të para, në shumën totale 63.000 euro;
- d) nuk është deklaruar në DPV pagesa e këstit të fundit në shumën 15.000 euro.

Komisioni ka vlerësuar se subjekti, me prapësimet dhe provat e paraqitura, nuk provoi bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasurinë.

5.3. Lidhur me apartamentin me sip. 55 m², në Lagjen {***}, {***}, Durrës, të përfituar nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. L. T., në vitin 2004, me vlerë 26.500 euro, dhe nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet trashëgimit, në përfundim të hetimit administrativ, Komisionit i rezultoi se:

- a) nuk u provuan pagesat e kryera nga babai i subjektit;
- b) nuk u provua financimi i kësaj pasurie nga motra e subjektit;
- c) prindërit e subjektit kanë mungesë burimesh të ligjshme për të krijuar pasurinë dhe për të përballuar shpenzimet në shumën (-) 1.986.250 lekë.

Për këto gjetje, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e tyre dhe, në përfundim të procesit të rivlerësimit, në vendimin objekt shqyrtimi, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk provoi të kundërtën e tyre.

5.4. Lidhur me lokalit me sip. 179 m², në {***}, Tiranë, të përfiturar nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. L. T., në vitin 2008, me vlerë 170.050 euro, dhe të fituar nëpërmjet trashëgimit nga subjekti i rivlerësimit, Komisionit i rezultoi se:

- a) nga analiza financiare për vitin 2008, ka rezultuar se prindërit e subjektit kishin mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie, në shumën (-) 17.633.583 lekë;
- b) nuk provoi pagesa të kryera nga i ndjeri L. T., për blerjen e pasurisë “lokal”;
- c) referuar kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve kontraktore, e cila është akt ligjor, dhe referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ka fuqinë e ligjit për palët, për pasojë, Komisioni vlerësoi se blerësi duhet të ketë paguar për këtë aset çmimin e cituar në kontratë, në shumën 170.050 euro;
- ç) në lidhje me disponimin e monedhave të arit nga familja Tominaj, nuk u provua ekzistenca e tyre;
- d) fakti se të ardhurat e gjeneruara nga kjo pasuri janë përfiturar nga subjekti, krijon bindjen se kjo pasuri ishte e tij, përpara se ta përfitonte me testament.

Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk provoi të ardhurat e ligjshme për krijimin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

5.5. Lidhur me depozitimet/tërheqjet në Credins Bank dhe Raiffeisen Bank, përkatësisht në shumën prej 9.500 eurosh, në datën 21.06.2007 dhe në shumën prej 10.000 eurosh, në datën 23.07.2009, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mundësi për të pasur “cash” shumat e depozituara në bankë, prej 9.500 eurosh në datën 21.06.2007 dhe prej 10.000 eurosh në datën 23.07.2009.

Komisionit, për faktin se subjekti nuk provoi bindshëm të ardhurat e ligjshme për krijimin e tyre, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, i rezultoi të jetë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë.

5.6. Lidhur me shpenzimet e studimit të vajzës, znj. Ç. T., në kolegjin “{***}”, në vitet 2004 – 2008, dhe shpenzimet e shkollimit për 8 vjet në Itali, Komisionit i rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë pretendimet se vajza ishte trajtuar me bursë të plotë në kolegjin “{***}” dhe se vajza ishte trajtuar me bursë në shtetin italian, vetëm për 2 vite.

6. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka arritur në konkluzionet përfundimtare se subjekti i rivlerësimit Blerim Tominaj:
 - i. nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive, të parashikuara në nenin D të Aneksit të Kushtetutës;
 - ii. ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, të parashikuara në germën “b” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016; dhe

iii. deklarim i pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

III. Në lidhje me shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit

7. Kundër vendimit nr. 261, datë 16.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 20.08.2020, ushtroi ankim subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenin F të Aneksit të Kushtetutës, nenet 62, 63 e vijues të ligjit nr. 84/2016, nenet 47 dhe 51, pika 1, germet “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), dhe nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNJ”), duke kërkuar:

- a) kalimin në seancë gjyqësore publike të çështjes administrative me nr. 261 vendimi, datë 16.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në lidhje me subjektin e rivlerësimit Blerim Tominaj;
- b) vazhdimin e hetimit administrativ dhe për tre komponentët e procesit të rivlerësimit që lidhen me pasurinë, figurën dhe aftësinë profesionale të subjektit të rivlerësimit Blerim Tominaj;
- c) ndryshimin e vendimit nr. 261, datë 16.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

7.1. Subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, ka depozituar në Kolegj, para seancës gjyqësore, parashtrimet e tij lidhur me shkaqet e ankimit.

8. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në Kolegj procedurën e kryer nga Komisioni, duke pretenduar se:

- a) Komisioni ka rrëzuar kërkesat për riçelje të hetimit, për vlerësimin e kriterëve të figurës dhe të aftësive profesionale, duke i përjashtuar ato si prova në shqyrtim, si dhe ka rrëzuar kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues;
- b) procesi ishte i njëanshëm dhe i paragjykuar në aspektin formal, për shkak se Komisioni është një organ që vetë heton, vetë analizon provat dhe më pas vetë gjykon e merr vendim;
- c) në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër parimit të një procesi të rregullt, Komisioni ka mbajtur një qëndrim refraktar, arbitrar, duke mos dhënë sqarime dhe arsye, duke mos marrë asnjë vendim në lidhje se pse nuk qëndrojnë shpjegimet dhe aktet e dorëzuara.

9. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar në Kolegj vlerësimin e kriterit të pasurisë, të kryer nga Komisioni, si më poshtë.

- a) Për sa i përket apartamentit me sip. 164 m², në rr. “{***}”, Tiranë, të përfituar në vitin 2007, me vlerë 2.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit pretendon se:
 - i) mosdetajimi në deklaratën *vetting* i kursimeve familjare si burim i krijimit të kësaj pasurie, nuk ka mospërputhje me sqarimet e dhëna gjatë hetimit administrativ,

- çmimi i referencës sipas EKB-së nuk është çmimi përfundimtar i një marrëdhënieje kontraktore, ai është sipas kontratës dhe në kushtet e ndihmës familjare motër-vëlla dhe në diferencën e çmimit janë përfshirë pagesat prej subjektit të rivlerësimit për vetratat, për një ashensor të dytë, si dhe pagesat e kontratave të furnizimit me ujë, drita, telefon;
- ii) nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën (-) 3.001.713 lekë, dhe në analizën financiare nuk është përfshirë vlera prej 1.200.000 lekësh nga shitja e apartamentit në vitin 2000, e depozituar në bankë, dhe në analizën financiare janë përfshirë shpenzimet e shkollimit të vajzës Ç. T., prej 3.400 eurosh, në kolegjin “{***}”.
- b) Për sa i përket lokalit me sip. 75 m², në rr. “{***}”, Tiranë, të përfituar në vitin 2011, me vlerë 140.000 euro, subjekti i rivlerësimit, në ankim pretendon se:
- i) si burim krijimi ka qenë edhe huaja prej 100.000 eurosh, në vitin 2010, nga z. Sh. P., e cila nuk është deklaruar si *cash* pasi nuk ishte administruar fizikisht; dhe
- ii) huaja prej 8.000 eurosh nga z. E. S., mosdeklarimi i së cilës në deklaratën *vetting* ishte një harresë, por kjo hua është deklaruar në deklaratën periodike vjetore 2011, si dhe
- iii) kursimet *cash*.
- c) Për sa i përket apartamentit me sip. 55 m² në Lagjen {***}, {***}, Durrës, të përfituar nga babai i subjektit të rivlerësimit në vitin 2004, me vlerë 26.500 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se:
- i) mandatarëtimet provojnë kryerjen e pagesave nga ana e z. L. T., pasi ato janë të rregullta dhe nuk kemi të bëjmë me mashtrim apo falsifikim;
- ii) deklarata e motrës së tij për dhënien e parave për financimin e apartamentit, është prova e vetme që mund të paraqitet në të tilla raste, dhe në asnjë rast Komisioni nuk e ka kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj deklarate apo të ketë pretenduar se është e falsifikuar apo të ketë goditur këtë provë.
- ç) Për sa i përket lokalit me sip. 179 m², në Rrugën e {***}, Tiranë, të përfituar nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. L. T., në vitin 2008, me vlerë 170.050 euro, subjekti i rivlerësimit pretendon se:
- i) babi i tij, z. L. T., nuk ka bërë asnjë pagesë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, pasi ai kishte rënë dakord me këtë shoqëri që do të paguante shumën prej 70.000 eurosh në favor të z. A. T., për shkak të revokimit të kontratës që kjo shoqëri kishte me të;
- ii) përveç vlerave të pensioneve të prindërve si çift, ishte edhe shuma prej 900.000 lekësh e cila i është dhënë babait nga subjekti i rivlerësimit pas shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, vlera prej 1.200.000 lekësh nga shitja e banesës dhe lokalit në Peshkopi dhe vlera e punës së kryer, prej 4.000.000 lekësh, e kryer në dyqanin rrobaqepësi në qytetin e Peshkopisë për rreth 6 vjet;
- iii) babai ka pasur burime të ligjshme për pagimin e çmimit 70.000 euro dhe, përveç sa më sipër, ka pasur edhe librezën e kursimit me mbi 800.000 lekë dhe rreth 2.000 euro, pra përpos pagesës së lokalit, ai ka pasur likuiditete të konsiderueshme;

- iv) nuk është e ndaluar të kryesh veprime financiare në emër dhe për llogari të dikujt tjetër, aq më shumë për babanë dhe se ka qenë harresa shkaku i mosdeklarimit të tërheqjeve të qirave nga llogaritë bankare.
- d) Për sa u përket depozitimeve/tërheqjeve në Credins Bank dhe Raiffeisen Bank, përkatësisht në shumën prej 9.500 eurosh në datën 21.06.2007 dhe në shumën prej 10.000 eurosh në datën 23.07.2009, lidhur me konkluzionet e Komisionit të treguara në paragrafin 5.5, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur shkak ankimi dhe, si pasojë, kontrolli i tyre nuk u trajtua nga trupi gjykues.
- dh) Për sa i përket konkluzionit të Komisionit për shpenzimet e studimit të vajzës, znj. Ç. T., subjekti i rivlerësimit pretendon se në kolegjin “{***}” jepeshin bonuse për nxënësit me përparim të mirë dhe në këtë kuadër, shpenzimet e vajzës kanë qenë 10% - 20% e vlerës, kurse për shkollimin në Itali, për vitet 2008 - 2011, vajza ka shpenzuar bursën e përfituar nga shteti italian, kurse shpenzimet e qëndrimit i ka pasur pa pagesë pasi ka jetuar në një familje italiane. Gjithashtu, subjekti pretendon se nga ana e tij, janë paguar për çdo vit shkollor shpenzimet e taksës shkollore prej 350 - 500 euro, si dhe një shpenzim fillestar çdo shtator prej 500 eurosh, dhe se për shpenzimet e jetesës së vajzës në Itali pas vitit 2010, është ndihmuar nga prindërit e tij në vlerën prej 1000 eurosh në vit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

i. Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Blerim Tominaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Trupi gjykues, pasi vlerësoi se nuk përmbushen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit nga Komisioni dhe çështje të zbatimit të legjislacionit procedural

13. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni i ka rrëzuar kërkesat për riçelje të hetimit për vlerësimin e kriterëve të figurës dhe të aftësive profesionale, për përjashtimin e trupit gjykues, trupi gjykues vëren se në themel të argumenteve të subjektit të rivlerësimit, ka qenë kryerja e procesit të rivlerësimit vetëm për kriterin e pasurisë, pasi:
- a) me vendimin, datë 11.06.2020, Komisioni ka refuzuar kërkesën për përfshirjen në procesin e rivlerësimit edhe të dy kriterëve të tjera, me arsyetimin se provat e grumbulluara për pasurinë, kishin nivelin e provueshmërisë; dhe
 - b) me vendimin, datë 12.06.2020, Komisioni ka rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për përjashtimin e trupit gjykues, me arsyetimin se nuk ishte i bazuar pretendimi se njoftimi për seancën dëgjimore për vetëm njërin nga kriteret, e bënte Komisionin të anshëm dhe paragjykes.

13.1. Në përputhje me jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i mbështetur, pasi kryerja e procesit të rivlerësimit vetëm për një kriter, atë të vlerësimit të pasurisë në rastin konkret, është një situatë procedurale që nuk bie ndesh me parashikimet kushtetuese dhe ligjore në fuqi dhe nuk demonstroi as paragjykim të trupës gjyqësore të Komisionit apo paracaktim të vendimit, për arsye se është e bazuar në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.

14. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se procesi ishte i njëanshëm dhe i paragjykuar në aspektin formal, për shkak se Komisioni është një organ që vetë heton, vetë analizon provat dhe më pas vetë gjykon e merr vendim, trupi gjykues vlerëson se nuk është i mbështetur, për sa kohë që veprimtaria e Komisionit, kompetencat e tij në kryerjen e procesit të rivlerësimit dhe mënyra e ushtrimit të tyre, janë parashikuar shprehimisht në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, kontrolli i kushtetutshmërisë së të cilit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 2, datë 18.01.2017.

14.1. Për pretendime të njëjta të kërkuesit me sa më sipër¹, në çështjen gjyqësore Xhoxhaj, kundër Shqipërisë, GjEDNj-ja ka vlerësuar se nuk ka shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “KEDNj”) në drejtim të parimit të gjykatës së paanshme.

15. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni në mënyrë të kundërligjshme dhe kundër parimit të një procesi të rregullt, ka mbajtur një qëndrim refraktar, arbitrar, duke mos dhënë sqarime dhe arsye, duke mos marrë asnjë vendim në lidhje se përse nuk qëndrojnë shpjegimet dhe aktet e dorëzuara në kuadër të barrës së provës, trupi gjykues vëren se ky pretendim nuk është i mbështetur. Nga aktet në dosje, trupi gjykues konstaton se Komisioni, për çdo pasuri, pasi mori në shqyrtim faktet që i rezultuan nga hetimi administrativ lidhur me deklarin e pasurive, ka kryer vlerësimin paraprak duke i kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës dhe, në përfundim të qëndrimeve të parashtruara dhe provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ka kryer analizën përfundimtare, duke arritur në konkluzione dhe vendimmarrje. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se Komisioni i ka garantuar subjektit të rivlerësimit të drejtën për të paraqitur prova dhe për t’u dëgjuar.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, në aspektin e konstatimit të drejtë të situatës faktike dhe zbatimit të ligjit material

16. **Lidhur me apartamentin me sip. 164 m², në rr. “{***}”, Tiranë**, rezulton që kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*, e përfituar nëpërmjet kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2007, me vlerë 2.000.000 lekë, dhe me burime nga kursimet familjare. Komisioni ka arritur në konkluzionet se ka mospërputhje deklarimesh për burimin e krijimit, çmimi nuk është real dhe shumë i ulët nga sa e ka blerë motra dhe nga sa e ka pasur vlerën në momentin e shitjes dhe subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen në shumën prej (-) 2.146.577 lekësh, konkluzione të cilat kundërshtohen nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se nuk ka mospërputhje në deklarin e burimit të krijimit, çmimi është sipas kontratës dhe se nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme.

16.1. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se është i gabuar konkluzioni i Komisionit se ka mospërputhje deklarimesh të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, pasi nëpërmjet shpjegimeve që ka dhënë gjatë hetimit administrativ, ai ka detajuar kursimet familjare të deklaruara si burim i krijimit të pasurisë në deklaratën *vetting*, trupi gjykues vëren se:

- a) në deklaratën periodike vjetore 2007, te rubrika e shtimit të kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar burimin e krijimit;
- b) në përgjigje të pyetësorit të Komisionit të datës 30.10.2019, si burim krijimi, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar 1.000.000 lekë nga shitja e apartamentit në rr. “{***}”, Tiranë, në vitin 2000 dhe 1.000.000 lekë nga kursimet nga pagat e tij dhe të bashkëshortes.

¹ Vendimi i GjEDNj-së, Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 230, 307, 308 dhe 317.

16.1.1. Trupi gjykues vlerëson se, në kushtet kur në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të krijimit të pasurisë kursime familjare, ky deklarim nuk e përjashton mundësinë që këto kursime të krijohen nga burime të ndryshme, siç mund të jenë kursimet nga pagat, vlerat monetare të krijuara nga shitja e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të tjera. Rezulton se Komisioni nuk ka konstatuar mospërputhje deklarimesh për burimin e krijimit të kësaj pasurie duke u nisur nga lloji i kursimeve të krijuara, por thelbësore ka qenë analiza nëse është ose jo i vërtetë skenari që pretendon subjekti i rivlerësimit për mënyrën e përdorimit të kursimeve familjare, duke u nisur nga fakti se subjekti pretendon përdorimin e një pjese të këtyre kursimeve të cilat gjendeshin në bankë edhe pas datës 02.02.2007, kur është lidhur kontrata e shitblerjes së apartamentit.

16.1.2. Sikurse do të analizohet në vijim, në pjesën e burimeve të krijimit të kësaj pasurie, trupit gjykues i rezultoi se kursimet e përdorura për këtë pasuri, burojnë nga pagat e subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes, duke u përjashtuar si burim të ardhurat nga shitja e apartamentit në rr. “{***}”, Tiranë, në vitin 2000, të cilat në momentin e blerjes së apartamentit, sipas deklarimeve të vetë subjektit të rivlerësimit, rezultojnë të kenë qenë gjendje në bankë, të patërhequra deri në datën 23.03.2007.

16.2. Për sa u përket pretendimeve të subjektit të rivlerësimit se çmimi i referencës i EKB-së, nuk është çmimi real, por çmimi real është ai i përcaktuar në kontratën e shitjes, në caktimin e të cilit, si rrjedhojë e marrëdhënies familjare motër-vëlla, janë marrë në konsideratë edhe shpenzimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë përdorimit, trupi gjykues mori në analizë rrethanat lidhur me përdorimin e sendit dhe kalimin e tij në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

16.2.1. Rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri në datën 02.02.2007 nga motra, znj. E. P., në çmimin prej 2.000.000 lekësh, e cila vetë e kishte blerë në datën 28.02.2000, në çmimin prej 2.600.000 lekësh² nga shoqëria “{***}” ShPK, në një çmim më të lartë se çmimi i blerjes nga ana e subjektit të rivlerësimit.

16.2.1.1. Nga aktet në dosje, rezulton se në momentin e shitjes nga motra te subjekti i rivlerësimit, duke u bazuar në çmimin e tregut prej 97.000 lekë/m² në vitin 2007³, kjo pasuri përlllogaritet në vlerën prej rreth 15.900.000 lekësh, e cila është shumëfish më e lartë se çmimi i blerjes nga subjekti i rivlerësimit, prej 2.000.000 lekësh. Për trupin gjykues, është i drejtë konkluzioni i Komisionit se çmimi i vendosur në kontratën e shitblerjes është një çmim joreal, por Komisioni, pavarësisht arsytimit të tij lidhur me çmimin në analizën financiare, çmimin e shitblerjes e ka vendosur në shumën 2.000.000 lekë dhe barrën e provës së subjektit të rivlerësimit, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme financiare, e ka bazuar në këtë skenar të mënyrës së ndodhjes së transaksionit.

² Përkatësisht $2.600.000 \text{ lekë} : 164 \text{ m}^2 = 15.854 \text{ lekë/m}^2$, ndërkohë që sipas VKM-së nr. 362, datë 14.07.2000, kostoja mesatare e ndërtimit për qytetin e Tiranës do të ishte 24.780 lekë, pa përfshirë kostot për rrjetin inxhinierik, projektin, studimin gjeologjik dhe sizmik, lejen e ndërtimit, truallin dhe shpenzime operationale të EKB-së, në masën 4%.

³ Udhëzim nr. 2, datë 4.4.2007, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive dhe të koeficientit “k”, për vitin 2007”.

Për rrjedhojë, çmohet se është e panevojshme analiza e shkaqeve që e bëjnë çmimin e shitblerjes joreal si në raport me çmimin e tregut, ashtu edhe në raport me çmimin e blerjes nga motra, për sa kohë Komisioni nuk i ka bërë një kualifikim të posaçëm ligjor kësaj situatë faktike, por e ka analizuar atë thjesht si një indicie në funksion të konkluzionit të arritur prej tij se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për këtë pasuri. Në këto kushte, edhe nëse do të pranohej pretendimi i subjektit të rivlerësimit se çmimi i kontratës së shitblerjes është real, për Kolegjin mbetet i rëndësishëm kontrolli i analizës financiare të Komisionit, lidhur me mungesën e burimeve të krijimit të pasurisë, në çmimin prej 2.000.000 lekësh.

16.3. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, se nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, në shumën (-) 3.001.713 lekë, trupi gjykues kontrolloi analizën e kryer nga ana e Komisionit për periudhën 2003 - 02.02.2007, nga e cila i rezultoi se Komisioni në faqen 12 të vendimit, ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën (-) 2.146.577 lekë.

16.3.1. Trupi gjykues vëren se mungesa e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në vlerën që i referohet subjekti i rivlerësimit, prej (-) 3.001.713 lekësh, i përket analizës financiare të rezultateve të hetimit në lidhje me këtë pasuri, e cila ishte paraprake dhe iu kalua subjektit të rivlerësimit në kuadër të barrës së provës. Për këtë arsye, trupi gjykues e gjeti të pambështetur pretendimin e subjektit të rivlerësimit, lidhur me referimin në rezultatin negativ prej (-) 3.001.713 lekësh, por kontrolloi konkluzionet e Komisionit në vendimin objekt shqyrtimi për mungesën e burimeve të ligjshme në vlerën (-) 2.146.577 lekë. Gjithashtu, trupi gjykues vëren se Komisioni, në analizën financiare, nuk i ka përfshirë shpenzimet e shkollimit për vajzën e subjektit të rivlerësimit në vitet 2004 -2007, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit dhe, si pasojë, pretendimi i tij për përfshirjen e tyre në mënyrë të gabuar në analizën financiare, nuk qëndron.

16.4. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, në analizën financiare të kryer në Komision, nuk janë llogaritur të ardhurat prej 1.200.000 lekësh nga shitja e apartamentit në rr. “{***}”, Tiranë, të cilat janë mbajtur *cash* në shtëpi, depozituar në Credins Bank në vitin 2006, dhe tërhequr në vitin 2007, trupit gjykues i rezultoi se në datën 21.03.2006, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në llogarinë e tij pranë Credins Bank, shumën prej 12.000 eurosh, likuiditete të cilat janë tërhequr nga Credins Bank në datën 23.03.2007, në shumën prej 12.306 eurosh.

16.4.1. Në kushtet kur tërheqja e likuiditeteve nga Credins Bank është kryer 49 ditë më vonë nga data e kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.02.2007, dhe shitësi ka deklaruar se *merr në dorëzim shumën 2.000.000 lekë*, trupi gjykues konstaton se këto likuiditete nuk mund të kenë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti.

16.5. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer nga Komisioni për periudhën 2003 - 02.02.2007, trupit gjykues i rezultoi se është përlllogaritur mundësia e subjektit të rivlerësimit për të justifikuar me burime të ligjshme kursimet *cash* prej 300.000 lekësh,

të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, si dhe kursimet *cash* prej 600.000 lekësh, të deklaruara në deklaratën periodike vjetore të vitit 2006, të cilat janë deklaruar si burim nga subjekti për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2007.

16.5.1. Nga këto përlogaritje, në analizën financiare të kryer për vitin 2005, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi për të krijuar kursimet *cash* prej 300.000 lekësh, ndërsa në vitin 2006 subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme, në shumën (-) 189.594 lekë, për të krijuar kursimet *cash* prej 600.000 lekësh.

16.5.2. Nga rezultati financiar i vitit 2006, i përlogaritur nga Komisioni, rezulton se kursimi *cash* prej 600.000 lekësh, i krijuar nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2006, është i pajustificuar me burime të ligjshme vetëm në shumën prej (-) 189.594 lekësh në këtë vit, ndërsa diferenca prej 410.406 lekësh, nga përlogaritjet e kryera nga vetë Komisioni, rezulton e krijuar me burime të ligjshme. Më tej, në analizën financiare të periudhës 2003 - 02.02.2007, të kryer nga Komisioni për blerjen e kësaj pasurie apartament, rezulton se *cash*-i i mundshëm prej 410.406 lekësh, nuk është përlogaritur si burim në analizën financiare të kryer për vitin 2007, duke u konsideruar në këtë mënyrë i gjithë *cash*-i i kursyer nga subjekti në vitin 2006, me mungesë burimesh të ligjshme.

16.5.3. Në këto kushte, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerësoi të marrë në konsideratë në analizën e burimeve për blerjen e kësaj pasurie deri në datën 02.02.2007, kursimet *cash* të mundshme, të justifikuara me burime të ligjshme prej 410.406 lekësh, rrjedhimisht duke ulur balancën negative në momentin e krijimit të pasurisë, në shumën prej (-) 1.537.828 lekësh, nga (-) 1.947.892 lekësh që i ka rezultuar Komisionit.

16.6. Në përfundim të kontrollit nga trupi gjykues të analizës financiare të periudhës 2003 - 02.02.2007, subjekti i rivlerësimit rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme, përkatësisht: a) në shumën (-) 8.590 lekë, në vitin 2003; b) në shumën (-) 189.594 lekë, në vitin 2006; c) në shumën (-) 1.537.828 lekë, në datën 02.02.2007 dhe, në total, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme në shumën prej (-) 1.736.012 lekësh, për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2007. Si rrjedhojë, gjendet i drejtë konkluzioni i Komisionit se nuk u provuan bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

16.7. Për sa më sipër, lidhur me apartamentin me sip. 164 m², në rr. “{***}”, Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti, duke qenë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

17. Lidhur me lokalin me sip. 75 m², në rr. “{*}”, Tiranë,** rezulton që kjo pasuri është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, e përfituar nëpërmjet kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 16.06.2011, me vlerë 140.000 euro, me burime nga kursimet familjare dhe akti noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2010. Komisioni, për këtë pasuri, ka arritur në konkluzionet e paraqitura më sipër në paragrafin 5.2, të cilat kundërshtohen nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se burim për krijimin e kësaj pasurie, kanë qenë: (i) huaja prej 100.000 eurosh, marrë z. Sh.

P., e cila pretendohet se nuk është administruar fizikisht prej subjektit të rivlerësimit; (ii) huaja prej 8.000 eurosh nga z. E. S.; dhe (iii) kursimet *cash*.

17.1. Rezulton se, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit, te rubrika e detyrimeve financiare ndaj personave fizikë e juridikë, ka deklaruar: *Hua për blerje apartamenti në vlerën 100.000 euro. Kontrata nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 02.07.2010, pa interes për 10 vjet. Huadhënës Sh. P., dhe te rubrika e ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, ka deklaruar: kursime nga pagat, në shumën 1.004.847 lekë. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, te rubrika e ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Lokal në rr. "{***}", sip. 75 m², blerë nga shtetasi A. B. me kontratën nr. {***}, datë 16.06.2011, në shumën 140.000 euro, dhe në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave fizikë e juridikë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar huan e marrë nga z. E. S., si burim për krijimin e pasurisë lokal: *Hua për blerje objekt - lokal në rr. "{***}"*. Deklaratë dore me shtetasin E. S., datë 07.06.2011, 8.000 euro, pa afat shlyerjeje dhe pa interesa.*

17.2. Në përgjigje të pyetësorit të Komisionit të datës 30.10.2019, lidhur me saktësimin e kursimeve familjare, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *100.000 euro i janë marrë borxh pa interes kunatit Sh. P.; 8.000 euro i janë marrë borxh pa interes mikut të familjes, z. E. S., pronar i firmës "{***}" në Durrës; 32.000 euro (konvertuar në lekë) nga kursimet familjare të viteve 2008 - 2011. Shumat respektive sipas viteve: 2008 - 1.500.000 lekë; 2009 - 1.355.000 lekë; 2010 - 1.000.000 lekë.*

17.2.1. Për sa i përket huas prej 100.000 eurosh nga z. Sh. P., si burim krijimi i kësaj pasurie, trupi gjykues vëren se kjo hua është marrë nëpërmjet deklaratës së dyanshme ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. Sh. P. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.07.2010. Në këtë deklaratë, huadhënësi deklaroi se: “[...] i kam dhënë [...] një shumë prej 100.000 (njëqind mijë) eurosh” dhe huamarrësi se: “[...] kam marrë [...] një hua prej 100.000 (njëqind mijë) eurosh”. Në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, aktet noteriale janë akte zyrtare dhe, si pasojë, kundërshtimi i përmbajtjes së tyre lidhur me deklaratimet që palët kanë bërë para noterit publik, lejohet vetëm në rast se do të pretendohet se ato janë të falsifikuara. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se është i pambështetur pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk e ka administruar fizikisht huan prej 100.000 eurosh nga z. Sh. P., pasi një fakt i tillë bie në kundërshtim me përmbajtjen e aktit noterial të hartuar në momentin e marrjes së huas.

17.2.2. Huaja prej 100.000 eurosh është deklaruar prej subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010 dhe në deklaratimet e dhëna në ILDKPKI në datën 18.02.2017, dhe duke nisur nga viti 2012, në deklaratat periodike vjetore janë deklaruar edhe shlyerjet në kuadër të kësaj huaje.

17.2.3. Pavarësisht se Komisioni vendosi ta përfshijë në analizën financiare të kësaj pasurie huan prej 100.000 eurosh nga z. Sh. P., gjendjen që hipotetikisht mund të kishte mbetur prej huas në shumën 3.665.970 lekë në fund të vitit 2010, nuk e ka përfshirë si burim në analizën financiare të vitit 2011, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar gjendje *cash* të mbetur në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010. Trupi

gjykues e vlerëson të drejtë këtë qëndrim të Komisionit pasi, pavarësisht nga ndryshimet që ka pësuar ligji nr. 9049/2003 dhe formulari i deklarimit, në rubrikën përkatëse, faqja 3 e formularit, që i përket pasqyrimin të shtesave dhe ndryshimeve të interesave privatë dhe pasurive të paluajtshme e të luajtshme, ligji në mënyrë konsistente ka kërkuar që subjektet deklaruese të shprehen për “[...] ndryshimet (shtesa dhe pakësime)” nga “deklarimi i mëparshëm deri më 31 dhjetor të vitit të deklarimit, që lidhen me zyrtarin, bashkëshortin/en dhe fëmijët madhorë [...]”. Legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë duke parashikuar që deklaratat përbëjnë dokumente zyrtare dhe mospërbushja e këtij detyrimi sillte pasoja për subjektet deklaruese.

17.3. Për sa i përket huas prej 8.000 eurosh, të marrë në vitin 2011 nga z. E. S., si burim krijimi, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratën *vetting*, por e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011 dhe gjatë deklarimeve të dhëna në ILDKPKI në datën 18.02.2016, si dhe ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në vitin 2012, sipas deklaratës periodike vjetore për vitin 2012. Për këtë arsye, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, çmon se kjo hua nuk duhet përjashtuar nga analiza në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të kontrolluar nëse subjekti i rivlerësimit përmbush detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj huaje.

17.3.1. Për sa i përket justifikimit me burime të ligjshme të huas prej 8.000 eurosh nga z. E. S., trupi gjykues vëren se në përgjigje të pyetësorit të Komisionit, datë 30.10.2019, përveç deklaratës datë 07.06.2011⁴, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se z. E. S. disponon një aktivitet në Durrës për prodhimin e mobilieve, duke dorëzuar dokumentacionin për sa vijon: a) lëvizjet bankare në llogarinë nr. {***} të shoqërisë “{***}” ShPK, në Bankën Amerikane të Investimeve, në monedhën euro, për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2011; b) lëvizjet bankare në llogarinë nr. {***} të shoqërisë “{***}” ShPK, në Bankën Amerikane të Investimeve, në monedhën euro, për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2011; c) lëvizjet bankare në llogarinë nr. {***} të shoqërisë “{***}” ShPK, në Bankën Amerikane të Investimeve, në monedhën euro, për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2011; dhe ç) lëvizjet bankare në llogarinë nr. {***} të shoqërisë “{***}” ShPK, në Bankën Amerikane të Investimeve, në monedhën lekë, për periudhën 01.01.2010 - 31.12.2011.

17.3.2. Nga lëvizjet bankare të këtyre llogarive, trupit gjykues i rezultojnë transaksione bankare të tilla, si: depozitime *cash*, tërheqje *cash* nga z. E. S., si dhe transfertat nga llogaria e shoqërisë për pagesa në funksion të aktivitetit të shoqërisë. Por, nga këto transaksione të kryera, nuk rezulton të jetë shpërndarë fitim nëpërmjet kalimit të dividendit nga shoqëria “{***}” ShPK tek ortaku, z. E. S., gjatë periudhës 2010 deri në datën 07.06.2011.

17.3.3. Nga shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 13.07.2017, e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Durrës (në vijim “DRTD”), drejtuar ILDKPKI-së, rezulton se shoqëria

⁴ Deklaratë me shkrim dore për dhënie të huas prej 8.000 eurosh më datë 07.06.2011, e nënshkruar nga shtetasi E. S. me vulën e shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe nga Blerim Tominaj.

“{***}” ShPK ka realizuar fitime neto, të cilat janë shpërndarë si dividendë pas dhënies së huas, përkatësisht në vitet 2011, 2012, 2014 dhe 2015.

17.3.4. Në këto kushte, trupit gjykues, vlerëson se, në kundërshtim me nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit nuk ka justifikuar ligjshmërinë e huas prej 8.000 eurosh të marrë nga z. E. S. në datën 07.06.2011 dhe, si pasojë, ajo nuk mund të përfshihet si e ardhur në analizën financiare për kontrollin e burimeve të ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

17.4. Për sa u përket kursimeve *cash* si burim krijimi, trupi gjykues kontrolloi deklaratimet periodike vjetore të viteve 2008, 2009 dhe 2010, nga të cilat i rezultoi se: a) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar te rubrika e ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, kursime nga pagat në shumën 400.000 lekë; b) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar te rubrika e ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, kursime nga pagat në shumën 855.608 lekë; c) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar te rubrika e ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, kursime nga pagat në shumën 1.004.847 lekë; dhe ç) në deklaratën periodike vjetore të vitit 2011, subjekti ka deklaruar te rubrika e ndryshimeve të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme, kursime nga pagat në shumën 369.456 lekë.

17.4.1. Për vitin 2008, nga përlllogaritjet e Komisionit në faqen 19 të vendimit, ky vit ka rezultuar me mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit, si dhe për të kursyer shumën e deklaruar *cash*, prej 400.000 lekësh, me një rezultat negativ prej (-) 545.861 lekësh. Nga kontrolli i kryer në Kolegj, u konfirmua si i drejtë ky konkluzion i Komisionit.

17.4.2. Për vitin 2009, nga kontrolli i analizës së Komisionit, rezulton se në rubrikën e “shpenzimeve” totale të kryera nga subjekti i rivlerësimit, paraqitet shuma 1.882.509 lekë, ndërkohë që nga mbledhja matematikore e çdo zëri të shpenzimeve të kryera për këtë vit, totali i shpenzimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit, rezulton në shumën 1.199.409 lekë dhe jo në shumën 1.882.509 lekë. Kjo përlllogaritje në mënyrë të gabuar e shumatores së zërave të veçantë të shpenzimeve totale për këtë vit, e kryer nga Komisioni, ka sjellë një rezultat financiar me mungesë të burimeve të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve, si dhe për krijimin e kursimeve *cash* për këtë vit, prej 855.608 lekësh. Për rrjedhojë, në Kolegj u përlllogarit shumatorja e zërave të veçantë të shpenzimeve të kryera prej 1.199.409 lekësh, duke rezultuar se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi burimesh financiare të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe për krijimin e kursimeve *cash* në shumën prej 855.608 lekësh, për këtë vit.

17.4.3. Për vitin 2010, nga kontrolli i analizës së Komisionit për mundësinë e krijimit të kursimeve *cash* me burime financiare të ligjshme prej 1.004.847 lekësh, konfirmohet rezultati financiar pozitiv, në vlerën 3.665.970 lekë. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi burimesh financiare të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe për krijimin e kursimeve *cash* në shumën prej 1.004.847 lekësh.

17.5. Por, pavarësisht faktit që subjekti i rivlerësimit rezulton se ka pasur mundësi kursimi në vitet 2009 dhe 2010, në kushtet kur si pasojë e rezultatit negativ të vitit 2008, nuk arrihet të justifikohet me burime të ligjshme e gjithë shuma e deklaruar e kursimit *cash* si burim për krijimin e kësaj pasurie, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se, në kushtet kur në deklaratën periodike të vitit 2011, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pakësimin e kursimeve *cash* në funksion të pagimit të kësteve të çmimit të kësaj pasurie, ato me të drejtë nuk janë përfshirë analizën financiare të vitit 2011, duke iu referuar qëndrimin të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen 7/2019 JR, datë 28.2.2019, ku arsyetohet se: [...] *Kolegji orienton Komisionin që në trajtimin e çështjeve të ngjashme në të ardhmen [...] të mos prezumojë përdorimin nga subjektet të gjendjeve "cash" si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar në mënyrë të qartë dhe të plotë nga vetë subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike. Si përfundim, konfirmohet si i drejtë konkluzioni i Komisionit se rezultati financiar i vitit 2011, është negativ për shumën (-) 9.338.582 lekë.*

17.6. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie në shumën (-) 9.338.582 lekë dhe, si rrjedhojë, gjendet i drejtë konkluzioni Komisionit se, me prapësimet dhe provat e paraqitura, nuk provoi bindshëm të ardhurat për krijimin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

17.7. Për sa më sipër, lidhur me lokalin me sip. 75 m², në rr. "{***}", Tiranë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar përfitimin e kësaj pasurie, duke qenë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa "b" e ligjit nr. 84/2016.

18. **Lidhur me pasurinë apartament me sip. 55 m², në {***}, {***}, Durrës,** rezulton se është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, i përfituar nga babai i tij, z. L. T., sipas kontratës së sipërmarrjes, datë 18.09.2004, me shoqërinë "{***}" ShPK, me vlerë 26.500 euro, me burim për subjektin e rivlerësimit nga dëshmia testamentare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.05.2012, dhe vendimi noterial për lëshim dëshmie trashëgimie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.03.2016. Komisioni ka arritur në konkluzionet se nuk u provuan pagesat e kryera nga babai, nuk u provua financimi i kësaj pasurie nga motra dhe prindërit kanë mungesë burimesh të ligjshme (-) 1.986.250 lekë, konkluzione të cilat kundërshtohen nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se mandatarkëtimet provojnë kryerjen e pagesave nga ana e z. L. T., pasi ato janë të rregullta dhe nuk kemi të bëjmë me mashtrim apo falsifikim dhe se deklarata e motrës së tij për dhënien e parave për financimin e apartamentit, është prova e vetme që mund të paraqitet në të tilla raste, dhe në asnjë rast Komisioni nuk e ka kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj deklarate apo të ketë pretenduar se është e falsifikuar apo të ketë goditur këtë provë.

18.1. Trupi gjykues konstaton se, në vendimin objekt shqyrtimi, Komisioni ka arsyetuar se cilat janë gjetjet e tij për të cilat, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të paraqitur prova ose shpjegime për të provuar të kundërtën e tyre, sa i përket provueshmërisë së pagesave të pretenduara si të kryera nga babai i tij, z. L. T., dhe financimit nga motra e tij në formën e dhuratës për

prindërit, në kushtet kur prindërit e subjektit të rivlerësimit kishin mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri. Komisioni gjithashtu arsyeton se për cilat arsye subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit, por nuk analizon dhe nuk vlerëson se cilat janë parashikimet ligjore të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 84/2016, të cilat duhet të zbatohen mbi situatën faktike të konstatuar, në ndryshim të dukshëm me mënyrën se si ka analizuar problematikat e pasurive të tjera të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara në deklaratën *vetting*, për të cilat ka treguar në mënyrë të qartë kualifikimin ligjor të situatave të tyre faktike. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se Komisioni, problematikat që lidhen me këtë pasuri, nuk i ka identifikuar si arsye për të bazuar vendimin e tij për dhënien ndaj subjektit të rivlerësimit të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për rrjedhojë, në kushtet kur konkluzionet e Komisionit në lidhje me situatën faktike, nuk kanë të bëjnë me veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit dhe që nuk janë dukshëm të paligjshme, trupi gjykues e vlerëson të panevojshëm analizimin e shkaqeve të ankimit për këto konkluzione të Komisionit, pasi ato nuk mund të sjellin pasojë në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, si në situatën e konfirmimit nga trupi gjykues të situatës faktike sipas konstatimeve të Komisionit, ashtu edhe në konfirmimin nga trupi gjykues të situatës faktike të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

19. Lidhur me pasurinë lokal me sip. 179 m², në Rrugën e {*}, Tiranë,** rezulton se kjo pasuri është deklaruar në deklaratën *vetting*, e përfituar nga babai i subjektit të rivlerësimit, z. L. T., nëpërmjet kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.05.2008, me shoqërinë “{***}” ShPK, me vlerë 170.050 euro, me burim për subjektin e rivlerësimit nga dëshmia testamentare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.05.2012 dhe vendimi për lëshim dëshmie trashëgimie nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 05.03.2016. Komisioni ka arritur në konkluzionet sipas paragrafit 5.4 më sipër në këtë vendim, ndërsa subjekti i rivlerësimit në ankim ka pretenduar se:

- i) babai i tij, z. L. T., nuk ka bërë asnjë pagesë në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, pasi ai kishte rënë dakord me këtë shoqëri që do të paguante shumën prej 70.000 eurosh në favor të z. A. T., për shkak të revokimit të kontratës që kjo shoqëri kishte me të;
- ii) përveç vlerave të pensioneve të prindërve si çift, ishte edhe shuma prej 900.000 lekësh, e cila i është dhënë babait nga subjekti i rivlerësimit pas shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, vlera prej 1.200.000 lekësh nga shitja e banesës dhe lokalit në Peshkopi dhe vlera e punës prej 4.000.000 lekësh, e kryer në dyqanin rrobaqepësi në qytetin e Peshkopisë për rreth 6 vjet;
- iii) babai ka pasur burime të ligjshme për pagimin e çmimit 70.000 euro dhe, përveç sa më sipër, ka pasur edhe librezën e kursimit me mbi 800.000 lekë dhe rreth 2.000 euro, pra përpos pagesës së lokalit, ai ka pasur likuiditete të konsiderueshme;
- iv) nuk është e ndaluar të kryesh veprime financiare në emër dhe për llogari të dikujt tjetër, aq më shumë për babanë dhe se ka qenë harresa, shkak i mosdeklarimit të tërheqjeve të qirave nga llogaritë bankare.

19.1. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se çmimi ishte 70.000 euro, trupit gjykues i rezulton se nga kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë

07.05.2008, shoqëria “{***}” ShPK kishte rënë dakord me z. L. T. për t’i shitur atij **dyqanin nr. {***}, me sip. 179 m²**, brenda 3 vjetësh, në çmimin prej 170.050 eurosh. Në përmbajtjen e kontratës, është treguar se çmimi i shitjes është likuiduar para redaktimit të kontratës dhe jashtë zyrës noteriale.

19.1.1. Trupi gjykues çmon se kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 12.10.2006, ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. A. T. për t’i shitur **dyqanin në katin e {***}, Seksioni {***}, me sip. 140 m²**, brenda 6 muajsh, në çmimin prej 70.000 eurosh, e cila u revokua me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.05.2008, duke u kthyer palët në gjendjen e mëparshme, është një situatë tjetër juridike e pavarur nga ajo e pasurisë objekt kontrolli. Nuk rezulton as në kontratën e revokimit ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. A. T. dhe as në kontratën e sipërmarrjes ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe z. L. T., ndonjë lidhje midis kontratave, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit, pasi marrëdhëniet juridike janë rregulluar midis palëve në mënyrë krejt të pavarur nga njëra-tjetra. Deklaratat noteriale që z. A. T. dhe shoqëria “{***}” ShPK kanë bërë në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit në vitin 2018, nuk mund të ndryshojnë përmbajtjen e akteve noteriale të hartuara në vitin 2008. Aktet noteriale kanë vlerë të plotë provuese për deklaratimet që shtetasit L. T., A. T. dhe përfaqësuesi i shoqërisë “{***}” ShPK kanë bërë para noterit publik, dhe këto deklarime nuk mund të ndryshohen nëpërmjet deklaratave noteriale të bëra rreth 10 vjet më vonë se hartimi i kontratave noteriale. Në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, kontratat e sipërcituara noteriale janë akte zyrtare dhe, si pasojë, kundërshtimi i përmbajtjes së tyre lidhur me deklaratimet që palët kanë bërë para noterit publik, lejohet vetëm në rast se do të pretendohet se ato janë të falsifikuara. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se çmimi i blerjes për këtë pasuri ka qenë 170.050 euro, sikurse palët e kanë përcaktuar me vullnetin e tyre të lirë para noterit publik dhe jo ai që pretendon subjekti i rivlerësimit, prej 70.000 eurosh.

19.1.2. Bazuar në sa më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se analiza financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme financiare për blerjen e kësaj pasurie, duhet t’i referohet çmimit të kontratës, prej 170.050 eurosh.

19.2. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare shumën prej 900.000 lekësh, e cila i është dhënë babait nga subjekti i rivlerësimit, pas shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 2000, trupi gjykues konstaton se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i mbështetur për sa i përket vlerës, pasi ajo nuk mund të jetë më tepër se 700.000 lekë. Trupi gjykues vëren se në deklaratën fillestare të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendje *cash* shumën 1.200.000 lekë, si pjesë të mbetur nga shitja e banesës në vitin 2000, çmimi i së cilës rezulton të ketë qenë 1.900.000 lekë⁵. Për rrjedhojë, duke zbritur nga çmimi i shitjes pjesën e deklaruar si gjendje *cash* nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të vitit 2003, prej 1.200.000 lekësh, rezulton se shuma e mbetur mund të ishte vetëm 700.000 lekë dhe jo 900.000 lekë, sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit. Në këto kushte, trupi

⁵ Kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.10.2000.

gjykues çmon se shuma e dhënë babait pas shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë, në vitin 2000, nuk mund të ketë qenë më tepër se 700.000 lekë.

19.3. Për sa i përket shumës prej 700.000 lekësh, trupi gjykues vëren se në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se kjo ishte një e ardhur e administruar nga i ndjeri [babai] në momentin e blerjes së apartamentit në Durrës, pa saktësuar përdorimin, por si pretendim e ka parashtruar në shkaqet e ankimit lidhur me lokalin me sip. 179 m², në Rrugën e {***}, Tiranë. Në ankim, gjithashtu subjekti i rivlerësimit lidhur me të ardhurat nga shitja e banesës në rr. “{***}”, Tiranë, ka pretenduar se: *kjo shumë e marrë nga im atë në vitin 2008, mund të jetë përdorur prej tij [babait] për shkollimin e vajzës [znj. Ç. T.]*. Pra, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk saktëson momentin e përdorimit të kësaj shume nga babai i tij dhe, si pasojë, trupi gjykues vlerëson se ajo nuk mund të bëhet pjesë e analizës financiare lidhur me kontrollin e kësaj pasurie.

19.4. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit për të ardhurat në vlerën 4.000.000 lekë nga rrobaqepësia në qytetin e Peshkopisë në vitet 1990 - 1996, nga shkresa kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 10.01.2019, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve, Sektori i Regjistrimit, drejtuar Komisionit, z. L. T. nuk figuron me aktivitet. Sipas vërtetimit, datë 17.12.2018, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Dibër, rezultoi se punëdhënësi individ fizik ka paguar kontribute për të siguruarin L. T. mbi pagën bruto prej 2.560 lekësh, për periudhën 01.04.1994 - 30.06.1994 (3 muaj), si dhe për periudhën 01.01.1995 - 31.03.1995 (3 muaj) ka paguar kontribute mbi pagën bruto prej 3.180 lekësh. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se babai i subjektit të rivlerësimit, krahas pensionit, ka ushtruar aktivitet si person fizik, rrobaqepës, në periudhat e sipërcituara, nga i cili mund të ketë krijuar të ardhura nga paga në shumën prej 5.030 lekësh neto në vitin 1994, dhe në shumën prej 6.248 lekësh neto në vitin 1995, por të ardhurat e pretenduara si të realizuara nga ky aktivitet tregtar në shumën prej 4.000.000 lekësh, mbeten në nivel deklarativ.

19.5. Për sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se babai i tij *ka pasur kursime në Credins Bank mbi 800.000 lekë dhe rreth 2.000 euro, rrjedhimisht* likuiditete të konsiderueshme, nga kontrolli i kryer në Kolegj, rezultoi se në datën 03.11.2004, në Credins Bank është depozituar *cash* shuma prej 500.000 lekësh në llogarinë dyemërore të z. L. T. dhe znj. F. T., si dhe në datën 13.12.2005 është depozituar *cash* shuma prej 165.000 lekësh, të cilat kanë qëndruar në bankë deri në datën 06.11.2008, kur rezulton se është tërhequr shuma prej 800.000 lekësh. Nga verifikimi i analizës financiare të kryer për vitin 2008 nga Komisioni, rezulton se kjo shumë e tërhequr nga banka, është përlllogaritur në zërin *ndryshim likuiditeti*, duke pasqyruar pakësimin në shumën -743.360 lekë, shumë kjo e cila përfaqëson ndryshimin e likuiditeteve (shitesë/pakësime) në të gjitha llogaritë bankare të babait të subjektit të rivlerësimit, përfshirë edhe pakësimin e likuiditeteve në Credins Bank, prej 800.000 lekësh për këtë vit. Gjithashtu, në datën 21.12.2006, në Credins Bank është depozituar *cash* shuma prej 1.619 eurosh, në llogarinë dyemërore të z. L. T. dhe znj. F. T., e cila ka qëndruar në këtë llogari dhe janë përfituar interesa, deri në datën 08.11.2018, kur janë tërhequr nga znj. F. T.. Në këto kushte, trupi gjykues vëren se, sa i takon kursimit prej 800.000 lekësh të tërhequr në vitin 2008 nga

Credins Bank, ai është marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer në Komision, dhe sa i takon kursimit pranë Credins Bank prej 1.619 eurosh, ky likuiditet ka qëndruar në Credins Bank deri në vitin 2018, pra ky kursim nuk është përdorur nga prindërit e subjektit për blerjen e pasurisë në vitin 2008. Si rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se është i pabazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ekzistenca e këtyre depozitave provon se babai i subjektit të rivlerësimit kishte burime të mjaftueshme të ardhurash për blerjen e kësaj pasurie.

19.6. Edhe në rastin e pranimit nga trupi gjykues të versionit më garantist për subjektin e rivlerësimit, nëse do të konsiderohej i provuar në favor të tij fakti se apartamenti në Durrës është financuar në formë dhurimi nga motra e tij për prindërit dhe nuk ka pasur burim kryesor kursimet e prindërve në periudhën 1993 - 2005, për rrjedhojë duke shtuar në analizën financiare të Komisionit, të paraqitur në tabelën përkatëse në faqen 32 të vendimit objekt kontrolli, në rubrikën “Të ardhurat”, edhe: (i) pensionet e prindërve të përfituara në periudhën 1993 - 2007, të cilat në total përlllogariten në shumën 2.008.421 lekë; (ii) të ardhurat nga pagat neto të përfituara nga babai i subjektit të rivlerësimit si rrobaqepës për periudhën 3-mujore në vitin 1994 dhe për periudhën 3-mujore në vitin 1995, të përlllogaritura në shumën totale prej 11.279 lekësh; (iii) të ardhurat nga interesat bankarë për periudhën 2005-2008, në shumën totale prej 167.867 lekësh; (iv) vlerën prej 700.000 lekësh, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit se i është kthyer babait prej tij, pas shitjes së apartamentit në rrugën “{***}”, Tiranë; (v) të ardhurat e përfituara nga prindërit e subjektit si pasojë e shitjes së apartamentit në vitin 1995 dhe dyqanit në vitin 2001, në Dibër, në shumën totale prej 1.200.000 lekësh; si dhe duke shtuar në rubrikën “Ndryshim likuiditeti”, vlerën prej 976.815 lekësh që përfaqëson shtesën e likuiditetit në bankë për periudhën 2004-2007 –atëherë do të kishim një rezultat negativ në vlerën - 14.522.832 lekë.

19.6.1. Trupi gjykues konstatoi se, nga hetimi i Komisionit në llogaritë bankare të z. L. T., në vitet 2010 – 2011, rezultuan kreditime të rregullta për pagesë qiraje, dhe se në datën 04.02.2011, subjekti i rivlerësimit ka tërhequr nga llogaritë bankare të z. L. T., shumën prej 10.500 eurosh dhe në datën 21.12.2011, ka tërhequr shumën prej 11.000 eurosh. Bazuar edhe në këtë fakt, Komisioni ka krijuar bindjen se kjo pasuri ishte e subjektit të rivlerësimit përpara se ai ta përfitonte nga trashëgimia me testamentin e babait. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se arsyet e tërheqjes së këtyre shumave ishin njerëzore, tërësisht të harruara prej tij dhe se nuk është e ndaluar të kryesh veprime financiare në emër dhe për llogari të babait. Trupi gjykues vlerëson se konkluzioni i Komisionit është i drejtë pasi fakti i mësipërm duhet të shikohet i lidhur me tërësinë e fakteve dhe rrethanave të konstatuara nga Komisioni, si dhe me dështimin e subjektit të rivlerësimit për të provuar me prova bindëse të kundërtën e gjetjeve për të cilat Komisioni i kaloi barrën e provës, me rezultatet e hetimit paraprak⁶. Kolegji mbajti në konsideratë edhe pohimin e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, se ai ishte përfshirë në negociata me shoqërinë sipërmarrëse “{***}” ShPK, në kuadër të blerjes së dyqanit nga babai i tij, ndërkohë ky i fundit rezultoi me mungesë të burimeve financiare të

⁶ Shih faqen nr. 24 të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit.

ligjshme për të justifikuar këtë transaksion. Në këto kushte, për trupin gjykues është e pabesueshme kryerja e këtij transaksioni nga babai i subjektit të rivlerësimit me një çmim shumë të lartë dhe në kushtet kur të ardhurat kryesore të tij, duke filluar nga viti 1993 e në vazhdim, i kishte nga pensioni i pleqërisë.

19.7. Për sa më sipër, trupi gjykues lidhur me lokalin me sip. 179 m² në Rrugën e {***}, Tiranë, vlerëson se, subjekti i rivlerësimit, qoftë sipas analizës financiare të Komisionit, nga e cila rezulton me një rezultat negativ në vlerën – 17.633.584 lekë, qoftë sipas një analize garantiste të Kolegjit si më sipër, ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar përfitimin e kësaj pasurie, duke qenë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Për sa i përket shkakut të ankimit që lidhet me konkluzionin e Komisionit për shpenzimet e studimit të vajzës, znj. Ç. T., të pasqyruar më sipër në paragrafin 5.6, në të cilin subjekti i rivlerësimit pretendon se në kolegjin “{***}” jepeshin bonuse për nxënësit me përparim të mirë dhe në këtë kuadër, shpenzimet e vajzës kanë qenë 10% - 20% e vlerës, kurse për shkollimin në Itali për vitet 2008 - 2011, vajza ka shpenzuar bursën e përfituar nga shteti italian, kurse shpenzimet e qëndrimit i ka pasur pa pagesë pasi ka jetuar në një familje italiane, si dhe pretendimit të subjektit se nga ana e tij janë paguar për çdo vit shkollor shpenzimet e taksës shkollore prej 350 - 500 eurosh, si dhe një shpenzim fillestar çdo shtator prej 500 eurosh dhe se për shpenzimet e jetesës së vajzës në Itali pas vitit 2010, është ndihmuar nga prindërit e tij në vlerën prej 1000 eurosh në vit, trupi gjykues çmon se Komisioni, në analizën e tij financiare, shpenzimet e subjektit të rivlerësimit për shkollimin e vajzës në kolegjin “{***}”, si edhe në Itali i ka vendosur në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit dhe, si pasojë, ato nuk kanë ndikuar në vendimin e dhënë nga Komisioni. Në këto kushte, shqyrtimi i këtij shkakut ankimi rezulton pa ndikim për kontrollin nga Kolegji të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi dhe, si rrjedhojë, trupi gjykues e vlerësoi të panevojshme kryerjen e një analize të posaçme të këtij shkakut ankimi.

21. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të parashtruara në shkaqet e ankimit, arriti në konkluzionet përfundimtare, si më poshtë.

21.1. Lidhur me apartamentin me sip. 164 m², në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti, duke qenë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

21.2. Lidhur me lokalin me sip. 75 m², në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij lokali, duke qenë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

21.3. Lidhur me lokalin me sip. 179 m² në Rrugën e {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar përfitimin e kësaj pasurie, duke qenë në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

22. Në këto kushte, trupi gjykues, në vijim të konkluzioneve të mësipërme, bazuar në nenin D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016,

vlerësoi se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, është i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, për rrjedhojë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 261, datë 16.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Blerim Tominaj, me detyrë prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
- U shpall sot, më datë 27.03.2023, në Tiranë.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi